

RAPORTI VJETOR 2006

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

RAPORTI
VJETOR
2006





SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

RAPORTI
VJETOR
2006



RAPORTI
VJETOR
2006



Mesazhi i Kryetarit	6
Ngjarjet Kryesore	7
Skema Organizative e AAB-së	8
Bordi Drejtues	9
Aktiviteti i AAB-së	10
- Ekzekutimi i Kolateralit	10
- Zyra e Informacionit mbi Kreditë	10
- Nismat Ligjore	10
- Kodi i Etikës Bankare	11
- Dërgesat e Emigrantëve	11
- Promocioni & Marketingu	12
- Aktivitetet Brenda Vendit & Pjesëmarrjet në Aktivitete Ndërkombëtare	14
- Konsulencat	15
Objektivat për Vitin 2007	16
Profili i Sekretariatit	17
Profili i AAB-së	18
Aktiviteti Financiar i AAB-së	20
Profili i Bankave në Shqipëri	28



Mesazhi i Kryetarit

Të dashur kolegë:

Viti 2006 ka qënë një vit plot ngjarje për sistemin financiar, gjatë të cilit disa investitorë të huaj blenë banka dhe shoqëri sigurimesh, një shenjë e qartë kjo e progresit të Shqipërisë drejt Evropës. Bankat shqiptare përjetojnë sot një ndërdepërtimet më të forta të kapitalit të huaj dhe privat në Evropë, fakt ky që i bën ato më shumë konkurrese dhe sektorin bankar më eficient se çdo sektor tjetër në vend.

Ndër arritjet e Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) gjatë 2006 do të theksoja peshën dhe rëndësinë gjithnjë në rritje të rolit të saj këshillimor ndaj enteve rregullatore dhe komunitetit të biznesit. Ajo u përfshi aktivisht në përgatitjen e ndryshimeve në Kodin e Procedurës Civile, ligjit të ri për bankat, ligjit për faktoringun, rregulloret e ndryshme të Bankës së Shqipërisë si dhe u bë anëtare e Këshillit Konsultativ të Biznesit. AAB vijoi të jetë zëri i komunitetit bankar dhe kontributi i saj është materializuar tashmë në ndryshimet e reja legjislative.

AAB hartoi gjithashtu dhe Kodin e Etikës Bankare, i miratuar unanimisht nga Asambleja, e që shërben si pikë reference për etikën e praktikave të biznesit bankar. Kjo ishte një arritje domethënëse dhe koherente, duke patur parasysh rëndësinë e etikës së biznesit dhe diferencën gjithnjë e më të vështirë midis etikes dhe ligjores.

Me zëvendësimin tim në detyrën e Kryetarit nga z. Edvin Libohova për një mandat të ri, besoj se gjatë 2007-ës na presin më shumë arritje (mendoj se tashmë ka një konsensus të plotë për të parë një Shoqatë Bankash më aktive në drejtim të çështjeve të trejnimeve dhe marrëdhënieve me publikun). Zgjedhja e z. Libohova, një bankier kompetent dhe me përvojë do të hapë rrugën për më shumë rotacion brenda bordit drejtues të AAB, praktikë kjo që përfundimisht do të krijojë një ndjenjë më të fortë përkatësie për të gjithë anëtarët. Solidariteti është thelbi i çdo shoqate!

Përhëndetje të përzemërta,

Seyhan Pencapligil
Kryetar

Ngjarje të Rëndësishme

- 1.** Miratimi i Kodit të Etikës Bankare;
- 2.** Inicimi dhe promovimi i procesit të diskutimeve dhe vendimarrjes për ngritjen dhe krijimin e Zyrës së Informacionit mbi Kreditë, brenda Bankës së Shqipërisë;
- 3.** Rritja e profilit këshillimor për autoritetet regullatore dhe vendimarrëse, lidhur me çështjet kryesore që prekin sistemin bankar shqiptar (ligji për bankat, ekzekutimi i kolateralit, mirëadministrimi i kredidhënies, etj);
- 4.** Rritja e profilit të përgjithshëm të AAB-së; AAB bëhet anëtare e Këshillit Konsultativ të Biznesit;
- 5.** Angazhim më i madh i sistemit bankar, në drejtim të zhvillimit të tregut të dërgesave të emigrantëve;
- 6.** Rritja dhe promovimi i një roli më social për sistemin bankar shqiptar, përmes nismës së grumbullimit të fondeve për financimin e projektit: “Bankat për internetin në shkolla”.



Bordi Drejtues i AAB



Kryetar

Seyhan PENCAPLIGIL
Drejtor i Përgjithshëm
BANKA KOMBËTARE TREGTARE



Nënkryetar

Steven GRUNERUD
Drejtor i Përgjithshëm
BANKA RAIFFEISEN – SHQIPËRI



Anëtar

Dimitris FRANGETIS
Drejtor i Përgjithshëm
BANKA TIRANA



Anëtar

Spiro BRUMBULLI
Drejtor
BANKA KOMBËTARE E GREQISË – Dega në Shqipëri



Anëtar

Edvin LIBOHOVA
Drejtor i Përgjithshëm
BANKA POPULLORE

Gjatë vitit 2006, AAB e përqendroi aktivitetin e saj në shumë çështje, ku ndër më të rëndësishmet do të theksonim:

■ Ekzekutimi i Kolateralit

Kjo çështje vijoi të ishte dhe këtë vit fokusi kryesor i aktivitetit të AAB-së, për vetë rëndësinë që ajo paraqet për aktivitetin e përditshëm të bankave. AAB pati angazhim maksimal dhe bashkëpunoi ngushtë me të gjithë grupet e interesit, për të siguruar rezultatet më të larta të mundshme për sistemin bankar.

Ajo vendosi kontakte dhe bashkëpunoi me Misionin Evropian të Asistencës për Sistemin e Drejtësisë në Shqipëri (EURALIUS), i cili kishte si detyrë dhënien e rekomandimeve Ministrisë së Drejtësisë, mbi ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile.

Gjithashtu, AAB pati një bashkëpunim të frytshëm dhe me Ministrinë e Drejtësisë, bashkëpunim ky që kulmoi me organizimin e përbashkët të takim-diskutimit me juristë të bankave, specialistë të Ministrisë së Drejtësisë dhe zyrtarë të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Përmbartimor, lidhur me ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile dhe procedurat për ekzekutimin e kolateralit. Takimi rezultoi dukshëm produktiv, ku një pjesë e mire e komenteve dhe propozimeve, të dhëna nga bankat, u përfshinë në projektligjin e ri: “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”. Ky projektligj pritet të paraqitet për diskutim e miratim në Kuvend, brenda tremujorit të parë të vitit 2007.

■ Zyra e Informacionit mbi Kreditë

Krijimi i Zyrës së Informacionit mbi Kreditë vazhdoi të ishte çështja dhe sfida më e madhe e sistemit bankar dhe e AAB-së gjatë vitit 2006.

AAB luajti një rol kyç në iniciimin e diskutimeve profesionale mbi formatin operacional të kësaj Zyre si dhe ngritjes së saj në Shqipëri. Nëpërmjet organizimit të përbashkët me shoqërinë EXPERIAN-SCOREX të dy propozimeve të biznesit, kursit të trajnimit mbi teknologjinë “scorecard” dhe mbi të gjitha, të takimeve me Bankën e Shqipërisë, AAB ndihmoi këtë të fundit në marrjen e vendimit përfundimtar për ngritjen e kësaj zyre brenda territorit të Shqipërisë, ku programet respektive të teknologjisë së informacionit do të zhvilloheshin me burime të brendshme. Pritet që Zyra e Informacionit mbi Kreditë të bëhet operative brenda gjysmës së dytë të vitit (mundësisht në fund të vitit 2007).

■ Nismat Ligjore

Ligji i ri “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”

AAB krijoi një Komitet Juridik të posaçëm (ad hoc), me qëllim përgatitjen e komenteve dhe sugjerimeve për projektligjin fillestar të ligjit “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, të përgatitur nga Banka e Shqipërisë. Komiteti Juridik dhe Sekretariati i AAB-së përgatitën një material përmbledhës, me të gjithë komentet e sugjerimet respektive. Pëveç këtij materiali, Sekretariati përgatiti dhe një dokument tjetër, në mbështetje të projektit të dytë të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të përgatitur po nga Banka e Shqipërisë.

Gjithashtu, AAB u ftua dhe në seancën dëgjimore të Komisionit të Ligeve të Kuvendit, ku u diskutua projekti ri i këtij ligji. Ky komision pranoi disa nga komentet e propozuara nga AAB.

Udhëzimet e Bankës së Shqipërisë: “Mbi administrimin e rrezikut të kredisë”, “Mbi mjaftueshmërinë e kapitalit” dhe “Mbi marrëdhëniet e personave të lidhur me bankat”.

Në vijim të Bankës së Shqipërisë, mbi disa shtesa dhe ndryshime të Rregulloreve: “Mbi administrimin e rrezikut të kredisë”, “Mbi mjaftueshmërinë e kapitalit” dhe “Mbi marrëdhëniet e personave të lidhur me bankat”, AAB propozoi, e më pas organizoi për këtë qëllim, një panel diskutimi me drejtorë të bankave, drejtues të departamenteve të kredisë së bankave si dhe me përfaqësues të lartë nga Banka e Shqipërisë. Paneli rezultoi frytdhënës, në drejtim të përgatitjes së rregulloreve me fleksible, në harmoni me kërkesat e sektorit bankar në këtë drejtim. Variantet përfundimtare të këtyre rregulloreve të rishikuara përmbajnë mjaftueshmërisht një pjesë të propozimeve të dhëna nga AAB.

Projekti i ri i Rregullores: “Mbi procedurat e ankandit për pasuritë e paluajtshme”, përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Përbarimor.

AAB, mbështetur në projektregulloren: “Mbi procedurat e ankandit për pasuritë e paluajtshme”, bashkërendoi dhe koordinoi të gjithë komentet e opinionet e bankave dhe ia kaloi ato për dijeni Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Përbarimor.

Projekti i ri i Ligjit: “Mbi Faktoringun”

AAB, mbështetur në projektin e ligjit: “Mbi Faktoringun”, të përgatitur nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, përgatiti një material përmbledhës me të gjithë opinionet e sistemit bankar, i cili ju dërgua dikasterit respektiv.

■ Kodi i Etikës Bankare

Asambleja e AAB-së, pasi shqyrtoi projektin e Kodit të Etikës Bankare, të përgatitur nga Sekretariati i AAB-së, e miratoi atë unanimisht, duke hedhur tashmë një hap të rëndësishëm drejt krijimit dhe sigurimit të përputhshmërisë me standardet etike dhe praktikat më të mira, brenda sistemit bankar shqiptar.

■ Dërgesat e Emigrantëve

Në vijim të nismës së ndërmarrë nga Banka Botërore për zhvillimin e Koridorit Itali – Shqipëri për Dërgesat e Emigrantëve dhe Konferencës së Barit në mars 2006, AAB filloi bashkëpunimin me Programin “Convergence” të Bankës Botërore dhe Shoqatën Italiane të Bankave ABI, për çështje të ndryshme. Konkretisht, AAB:

u angazhua në studimin e shpërndarjes gjeografike të emigrantëve shqiptarë në Itali, në vijim të Konferencës së Barit. Ky studim kishte synim krijimin e një harte të shpërndarjes rajonale të emigrantëve shqiptarë në Itali, për të hartuar një strategji produkti me bazë dërgesat e emigrantëve, kryesisht për bankat në Shqipëri. Gjithashtu, projekti kishte si qëllim dhe promovimin e ofrimit të integruar të shërbimeve bankare në Itali dhe Shqipëri, si dhe zhvillimin e një game produktesh financiare (përfshirë dhe dërgesat e emigrantëve). AAB dha ndihmesë të vlefshme për Programin “Convergence” dhe ABI-n, duke u vënë atyre në dispozicion të dhëna lidhur me transferimin e fondeve nga emigrantët shqiptarë në Itali, nëpërmjet sistemit bankar shqiptar;

organizoi në korrik të 2006, Forumin e Hapur njëditor me temë: “Përfitimet nga Dërgesat e Emigrantëve”, në formën e një paneli të mëtejshëm diskutimi, ku u paraqitën e u diskutua me bankat shqiptare rreth përfundimeve të studimit të lartpërmendur. Forumi pati si qëllim gjithashtu, identifikimin e hapave të mëtejshëm që mund të ndërmarrin bashkarisht bankat shqiptare dhe ato italiane, me qëllim fokusimin e planeve të tyre respektive të biznesit, drejt ofrimit të shërbimeve financiare për emigrantët shqiptarë në Itali;

mori pjesë me një delegacion të nivelit të lartë në një takim biznesi, të organizuar nga ABI dhe Programi “Convergence” në Milano, Itali, më 02 nëntor 2006, me një grup përfaqësuesish të bankave italiane. Takimi synoi të zgjeronte më tej bashkëpunimin midis bankave shqiptare dhe atyre italiane, nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të korridorit Itali-Shqipëri për dërgesat e emigrantëve, si dhe diskutimin e gjetjen e mundësive të reja për një përdorim më të zgjeruar të kanaleve bankare për këto dërgesa;

bëhet në dhjetor 2006 anëtare e plotë e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Dërgesat e Emigrantëve, në kuadër të projektit të IOM për dërgesat e Emigrantëve dhe Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin.

■ Promovimi & Marketingu

Faqja e internetit të AAB-së (<http://www.aab.al>).

AAB filloi të publikojë në faqen e saj të internetit të dhënat e paaudituar të bankave për çdo tremujor, duke kontinuar kështu për një transparencë më të lartë ndaj publikut të gjerë rreth të dhënave bankare (path: <http://www.aab.al/eng/statistika.asp>).

Spoti televiziv i AAB-së

AAB, si pjesë të strategjisë promovionale për sistemin bankar, filloi prodhimin e një spoti televiziv, lidhur me përdorimin e instrumenteve moderne të pagesave jo-cash nga publiku i gjerë dhe më konkretisht, të kartave elektronike bankare. Ajo përgatiti skenarin e spotit dhe mendohet që, spoti të transmetohet brenda gjysmës së parë të vitit 2007, falë dhe mbështetjes financiare nga VISA International, si bashkësponsorizues i fushatës publicitare në fjalë.

Nisma e grumbullimit të fondeve për projektin: “Bankat për Internetin në Shkollë”

Kjo nismë u konceptua si hapi i parë, në drejtim të rritjes së profilit social dhe imazhit publik të sistemit bankar shqiptar, si dhe rritjen e vetë imazhit të AAB-së. Sipas kësaj nisme, të gjitha bankat kontribuan me një fond të barabartë prej 3,000 EURO, për të mbështetur krijimin e laboratorëve të internetit në disa shkolla tetëvjeçare dhe të mesme në vend. Fondet do t’i dhurohen Zyrës së PNUD-it në Tiranë, e cila është përgjegjëse për zbatimin e projektit “Interneti në Shkollë”.

■ Aktivitetet Brenda Vendlit dhe Pjesëmarrjet Ndërkombëtare

Aktivitetet & Seminaret Brenda Vendlit

Sekretariati i AAB-së, si pjesë të aktivitetit të tij, sponsorizoi, organizoi dhe bashkëpunoi si organizator në aktivitetet dhe seminarët në vijim:

Seminar trainimi: “Zbatimi në Praktikë i Teknologjisë së “Tabelës së Rezultateve” (Scorecard), organizuar më 22 shkurt 2006, në bashkëpunim me EXPERIAN–SCOREX. Në seminar u prezantuan aplikimi i parimeve të tablës së rezultateve (scorecard) për akordimin e kredive, llojet e ndryshme këtyre tabelave, teknikat e ndryshme të vlerësimit, metodologjitë e analizave për akordimin e kredive, etj. Në seminar u prezantuan dhe disa raste studimore, për të demonstruar përdorimin praktik të këtyre koncepteve. Gjithashtu, në seminar u prezantuan gjerësisht dhe disa analiza thelluara mbi instrumentet dhe metodologjitë më të fundit, që përdoren për përmirësimin e kapaciteteve vendim-marrëse dhe manaxhimin strategjik të biznesit bankar për këtë qëllim.

Takim pune: “Zhvillimi i Sektorit Bankar dhe Rritja e Kredisë në Shqipëri”, organizuar më 20 mars 2006, me Kryeministrin, SH.T.Prof.Dr. Sali Berisha. Ky takim ishte një shenjë e rëndësishme e vëmendjes së Qeverisë shqiptare kundrejt çështjeve që ndesh sektori bankar gjatë aktivitetit të tij. Në këtë takim, Kryeministri, në emër të Qeverisë shqiptare, u angazhua për t’i zgjidhur këto çështje në rrugën më të efektshme e të përshtatshme për sektorin bankar. Në këtë takim, Kryetari i AAB-së, z Seyhan Pencapligil, mbajti fjalimin me temë: “Zhvillimi i sektorit bankar dhe rritjes së kreditimit për ekonominë (mbështetës, bashkëorganizator).

Seminar Prezantues: “Si mund të kontribuojë Sektori Bankar Shqiptar në Përmirësimin e Ndërmjetësimit Financiar”, organizuar më 03 prill 2006, në bashkëpunim me Programin “Convergence”. Në këtë seminar, u prezantua studimi i përgatitur nga Prof. Francesco Cesarini, mbi funksionet dhe organizimin e Shoqatës Italiane të Bankave, ABI, si dhe në prezantimin e instrumenteve manaxheriale dhe kapaciteteve teknike, të zhvilluara nga ABI, me qëllim të shndërrimit të kësaj të fundit në një partner të besueshëm dhe të përgjegjshëm, për hartimin e politikave të ndryshme ekonomike. Kjo eksperiencë iu sugjerua për zbatim dhe AAB-së, gjatë procesit të krijimit të kapaciteteve respektive dhe për të rritur e zgjeruar kontributin e saj në drejtim të zhvillimit të sektorit financiar – në bashkëpunim me autoritetet monetare dhe financiare të vendit (sponsor, mbështetës, bashkëorganizator).

Tryezë e rrumbullakët: “Krijimi i Zyrës së Informacionit mbi Kreditë në Shqipëri: Propozim Biznesi”, organizuar më 28 prill 2006, në bashkëpunim me EXPERIAN–SCOREX. Në këtë tryezë, ekspertët e EXPERIAN–SCOREX prezantuan propozimin e tyre të biznesit, i cili u fokusua kryesisht në krahasimin e kostove dhe zgjidhjeve teknike të variantit me nënkontraktim (jashtë vendit) ndaj atij brenda vendit (in-house) (sponsor, mbështetës, bashkëorganizator).

Seminar: “Mbi Eksperiencat Ndërkombëtare për Rritjen e Kreditimit”, 02 maj 2006, i organizuar në bashkëpunim me Misionin resident të FMN-së në Tiranë dhe Bankën e Shqipërisë. Seminari u fokusua në eksperiencat ndërkombëtare lidhur me rritjen e kreditimit. Në seminar, z. Jan Willem van der Vossen prezantoi një material kërkimor: “Rritja e Shpejtë e Kreditimit ndaj Sektorit Privat”, ndërsa z. Geoffrey Oestreicher, prezantoi materialin: “Fakte të Stilizuara dhe Ndikimi Makroekonomik mbi Rritjen e Kreditimit”. Ky material ishte pjesë e misionit “Article IV” që FMN ndërmori në Shqipëri, gjatë periudhës 1-5 maj 2006 (mbështetës, kombëtare, bashkëorganizator).

Forum i Hapur Diskutimesh: “Të kuptuarit dhe Përfitimet nga Dërgesat e Emigrantëve – Mundësitë për ofrimin e përbashkët të shërbimeve financiare emigrantëve shqiptarë në Itali, nga ana e bankave italiane dhe shqiptare”, i organizuar më 27 korrik 2006 në bashkëpunim me Shoqatën Italiane të bankave, ABI dhe Programin “Convergence”. Në forum u bënë dy prezatime:

1. **“Të kuptuarit e Tregut Italo-Shqiptar të Dërgesave të Emigrantëve”, nga z. Pierfrancesco Gaggi, Zëvendës Drejtor për Tregjet, ABI,**
2. **“Përfitimet nga Dërgesat e Emigrantëve; Si mund të lidhesh me lojtarët kryesorë në Itali?”, nga z. Luigi Passamonti, Drejtor i Programit “Convergence”.**

Të dy prezantimet sollën të dhëna të vlefshme mbi tregun italian të dërgesave të emigrantëve shqiptarë si dhe mbi kërkesën e mundshme për shërbime financiare. Qëllimi i forumit ishte identifikimi i hapave të mëtejshme që mund të ndërmerren së bashku nga bankat italiane dhe shqiptare, me qëllim fokusimin e planeve të tyre të biznesit drejt shërbimeve financiare për emigrantët shqiptarë në Itali (sponsor, mbështetës, bashkëorganizator).

Panel i Diskutimit: “Rregullat mbi Administrimin e Rrezikut të Kredisë”, organizuar më 10 nëntor 2006, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë. Ky panel diskutimi u zhvillua në vijim të propozimeve të Bankës së Shqipërisë rreth disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren: “Mbi Rrezikun e Administrimit të Kredisë”, Rregulloren: “Mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit” dhe Rregulloren: “Mbi Marrëdhëniet e Bankës me Personat e Lidhur me Të”. Në këtë panel morën pjesë drejtues të përgjithshëm të bankave, drejtues të departamenteve të kredisë së bankave si dhe zyrtarë të lartë nga Banka e Shqipërisë. Në panel u shpалosën këndvështrimet e të dy palëve, si dhe u paraqitën dhe disa propozime e sugjerime shtesë, lidhur me shtesat dhe ndryshimet respektive në rregulloret e sipërpërmendura (sponsor, mbështetës, bashkëorganizator).

Takim-Diskutimi: “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Civile (KPC)”, i organizuar më 20 dhjetor 2006, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë. Takim-diskutimi, që u ndoq nga juristë të bankave, zyrtarë të lartë të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Përmbartimor, u fokusua në diskutime profesionale e teknike rreth ndryshimeve dhe shtesave të propozuara nga Ministria e Drejtësisë në KPC, veçanërisht në lidhje me çështjen e ekzekutimit të kolateralit (sponsor, mbështetës, bashkëorganizator).

Pjesëmarrjet dhe Prezantimet Ndërkombëtare

AAB mori pjesë në aktivitetet e mëposhtme ndërkombëtare:

Kryetari i AAB-së, z. Seyhan Pencapligil, mori pjesë në Konferencën e Bankës Botërore: “Dërgesat e Emigrantëve: Një mundësi për Rritje/Emigracioni Shqiptar në Itali, si një Rast Studimor”, Bari, Itali, 4 mars 2006, ku ai mbajti dhe një fjalim me temë: “Mbi Dërgesat e Emigrantëve”.

Në kuadër të Konferencës së 15të të BACEE për Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, 14-16 nëntor 2006, në Budapest, Hungari, Kryetari i AAB-së, z. Seyhan Pencapligil, paraqiti prezantimin me temë: “SHQIPERIA – Ekonomia dhe Sistemi Bankar - 2005”.

AAB mori pjesë me Sekretarin e Përgjithshëm, në Mbledhjen e 22të të Anëtarëve të Asociuar të Federatës Evropiane të Bankave, FBE, në Stamboll, Turqi, më 19 maj 2006.

AAB mori pjesë me Sekretarin e Përgjithshëm, në Mbledhjen e Forumit Ndërbankkanik të Shoqatave të Bankave, IFBA në Beograd, Serbi, në 12 maj 2006, ku u diskutuan çështjet e mëposhtme:

- **Prezantim i Shoqatës Serbe të Bankave, ASB, mbi:**
 - *Byronë e Kredive,*
 - *Bazel II,*
 - *Nisma e ASB për zhvillimin e shpejtë të 8 tregjeve ndërbankare,*
 - *Kleringu i çeqeve,*
- **Funksioni vetrregullator i Shoqatave të Bankave,**
- **Mirëadministrimi i bankave (Komiteti i Bazelit: Zgjerimi i mirëadministrimit të bankave,**
- **Funksioni i përputhshmërisë në banka, përfshirë dhe funksionin e parandalimit të pastrimit të parave (Materiali i Komitetit të Bazelit: Përputhshmëria dhe funksioni i përputhshmërisë në banka),**
- **Nismat më të fundit legislative në BE,**
- **Manuali i Sistemeve Bankare në Ballkan: Raport i Progresit,**
- **Faqja e Internetit të Forumit Ndërbankanik: Raport i Progresit,**
- **Pas – FSAP (Plani i Veprimt të Shërbimeve Financiare).**

■ **Konsulencat**

Kuadri Ligjor mbi Huamarrjen Lokale

Local Government and Decentralization in Albania (LGDA), një projekt i financuar nga USAID, u angazhua në procesin e përgatitjes së një dokumenti politikash, në fushën e huamarrjes lokale dhe sigurimit të aksesit respektiv në huamarrje, nga ana e enteve lokale. Dokumenti synon të hedhë bazat për hartimin dhe përgatitjen përfundimtare të një ligji të veçantë për huamarrjen lokale. LGDA së bashku me partnerin e saj local, Institutin e Studimeve Bashkëkohore, ISB, organizoi gjashtë takim-diskutime, gjatë periudhës prill–maj 2006, në të cilët u ftuan pjesëmarrës nga grupet kryesore të interesit, ose që mund të luajnë një rol kyç në këtë proces. Sistemi bankar, si një nga grupet kyçe të interesit, mori pjesë në të gjithë këto takime, ku u angazhua aktivisht në diskutime.

Këshilli Konsultativ i Biznesit

AAB u pranua zyrtarisht si anëtare e Këshillit Konsultativ të Biznesit, një organ këshillimor ky për Qeverinë shqiptare, e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm i saj. Ky anëtarësim konsiderohet si një dritare e dobishme, nëpërmjet së cilës mund t'i adresohen Qeverisë çështjet, problematikat dhe propozimet respektive lidhur me politikat ekonomike e nismat ligjore të saj, të cilat drejtpërdrejt apo tërthorazi, ndikojnë mbi aktivitetin bankar në Shqipëri.

Objektivat për Vitin 2007:

Për vitin 2007 AAB do të ketë këto prioritete dhe objektiva kryesore:


- ▣ Krijimi dhe ofrimi i mundësive dhe alternativave trejnuese me kosto të ulët, për bankierët shqiptarë,**
- ▣ Krijimin e një platforme praktike dhe të dobishme informacioni për bankat anëtare,**
- ▣ Përmirësimin e kapaciteteve organizative dhe funksionimin administrativ të saj,**
- ▣ Vijimin e promovimit të shërbimeve bankare dhe profilit të saj në publikun e gjerë.**

Profili i Sekretariatit



SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Elvin Meka
Sekretar i Përgjithshëm



SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Junida Katroshi
*Asistente e Sekretarit
të Përgjithshëm*



SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Brunilda Kostare
Konsulente Ligjore

Anëtarësimi në Organizata Ndërkombëtare:

Anëtar i asociuar i FBE – Federata Europiane e Bankave , 2003 www.fbe.be

Komiteti Ekzekutiv:

z. Seyhan PENCAPLIGIL, Kryetar
 z. Steven GRUNERUD, zv. Kryetar
 z. Dimitris FRANGETIS, Anëtar
 z. Edvin LIBOHOVA, Anëtar
 z. Spiro BRUMBULLI, Anëtar


















Sekretariati:

z. Elvin MEKA, MBA
 Sekretar i Përgjithshëm

Struktura Organizative :

Forma Ligjore: Organizatë jofitimprurëse.
 Anëtarësimi: 17 banka tregtare (vullnetar).

■ Anëtarët e Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB):

	Italian-Albanian Bank
	Alpha Bank - Albania
	National Bank of Greece - Albania
	American Bank of Albania
	National Commercial Bank
	Credins Bank
	Popular Bank
	Credit Bank of Albania
	ProCredit Bank
	Italian Development Bank
	Raiffeisen Bank - Albania
	Emporiki Bank – Albania
	Tirana Bank
	First Investment Bank
	Union Bank
	International Commercial Bank
	United Bank of Albania



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS

ABOUT US | MEMBERS | BOARD/MYSELF | PUBLICATIONS | LINKS | CONTACT | SITE MAP



Welcome!

Albanian Association of Banks is a not-for-profit association, which seeks to promote the most up-to-date banking standards of its member banks, the development, stability and efficiency of Albanian banking system in general, thereby contributing to the advancement of the Albanian economy. AAB is a representative body to contribute in the formulation of legislative proposals or in technical committees, on the national and international

REUTERS

To get information about currencies' exchange rates in the world...

[Click here!](#)

LATEST NEWS

MEMBERS

- Alpha Bank
- American Bank of Albania
- Crédit Bank
- Crédit Bank of Albania
- Banka Ndërore e Zhvillimit
- Erzincan Bank
- First Investment Bank
- International Commercial Bank

Adresa:

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Blvd. "Dëshmorët e Kombit" KULLAT BINJAKE, Kulla 1, kati 6, Nr. 3

TellFax: +355 4 280 371

Tel: +355 4 280 372

e-mail: secretariat@aab-al.org

URL: <http://www.aab.al>



Pasqyrat Financiare 31 dhjetor 2006

Përmbajtja

Bilanci	21
Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	22
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë	23

Shënime në Pasqyrat Financiare

1. Informacion i Përgjithshëm	24
2. Baza e Përgatitjes	24
3. Përmbledhje e Politikave Kontabël	24
4. Arka dhe Banka	25
5. Aktivët e Qëndrueshme	25
6. Kuotat e Anëtarësisë	26
7. Interesat Bankare	26
8. Të Ardhura të Tjera	26
9. Amortizimi i Akumuluar	26
10. Shpenzimet e Përgjithshme dhe ato të Administrimit	27
11. Diferencat nga Kursi i Këmbimit	27

Shoqata Shqiptare e Bankave

Bilanci kontabël në datë 31 dhjetor 2006 dhe 31 dhjetor 2005 (në Lek)

	Shënimi	31 Dhjetor 2006	31 Dhjetor 2005
Aktivet			
Arka dhe Banka	4	8,539,044	2,636,480
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		8,539,044	2,636,480
Aktivet Afatgjata			
Aktivet e qëndrueshme, neto	5	776,457	1,002,874
Totali i Aktiveve Afatgjata		776,457	1,002,874
Totali i Mjeteve		9,315,501	3,639,354
Aktivet Neto		9,315,501	3,639,354
Totali i Detyrimeve dhe Aktiveve Neto		9,315,501	3,639,354

Bilanci duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse 4 deri 11, si pjesë e pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) janë përpiluar dhe nxjerrë në datë 26.02.2007 dhe nënshkruar nga:

Elvin MEKA
Sekretar i Përgjithshëm
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



Edmond GORE
Audit i Brendshëm
BANKA AMERIKANE E SHQIPERISE



Shoqata Shqiptare e Bankave

Pasqyra e Të Ardhurave dhe Shpenzimeve në datë 31 dhjetor 2006 dhe 31 dhjetor 2005

(në Lek)

	Shënimi	31 Dhjetor 2006	31 Dhjetor 2005
Të Ardhurat			
Kuotat e Anëtarësisë	6	10,170,000	8,371,578
Kuotë speciale për projektin (internet për shkollë)		3,343,950	-
Interesat Bankare	7	-	11,975
Të Ardhura të Tjera	8	171,202	124,296
Totali i të Ardhurave		13,685,152	8,507,849
Shpenzimet			
Amortizimi i Akumuluar	9	226,417	142,729
Shpenzimet e Përgjithshme dhe të Administrimit	10	7,763,544	5,678,004
Diferencat nga Kursi i Këmbimit	11	19,044	36,832
Totali i Shpenzimeve		8,009,005	5,857,565
Teprica/(Deficiti) i të Ardhurave ndaj Shpenzimeve		5,676,147	2,650,284
Aktivitet Neto në fillim të vitit		3,639,354	989,070
Aktivitet Neto në fund të vitit		9,315,501	3,639,354

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse 4 deri 11, si pjesë e pasqyrave financiare.

Pasqyra e Rrjedhës së Parasë në datë 31 dhjetor 2006 dhe 31 dhjetor 2005

(në Lek)

	Shënimi	31 Dhjetor 2006	31 Dhjetor 2005
Rrjedha e Parasë nga Aktivitetet Operacionale			
Teprica/(Deficiti) e të Ardhurave ndaj Shpenzimeve		5,676,147	2,650,284
Rregullime për:			
Amortizimin		226,417	142,729
Teprica e Parave nga Aktivitetet Operacionale		5,902,564	2,793,013
Investimet			
Blerje të Aktiveve të Qëndrueshme		-	749,706
Rrjedha e Parasë nga Aktivitetet Investuese		-	749,706
Rritja Neto në Rrjedhën e Parave		5,902,564	2,043,307
Arka dhe Banka në Fillim të Vitit		2,636,480	593,173
Arka dhe Banka në Fund të Vitit	4	8,539,044	2,636,480

Pasqyra e rrjedhës së Parave duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse 4 deri 11, si pjesë e pasqyrave financiare.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare 31 dhjetor 2006

(Të gjitha në LEK përveçse kur përcaktohet ndryshe)

1. Informacion i Përgjithshëm

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është themeluar në 31 PRILL 1999.

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është një shoqatë jo-fitimprurëse, e cila përpiqet të promovojë standartet më të fundit bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sistemit bankar shqiptar në përgjithësi, duke kontribuar kështu në përparimin e ekonomisë shqiptare. AAB përbëhet nga shtatëmbëdhjetë anëtarë, mbi baza vullnetare: Alpha Bank – Dega në Shqipëri, Banka Amerikane e Shqipërisë, Banka Credins, Banka Emporiki – Shqipëri, Banka Italiane e Zhvillimit, Banka Italo-Shqiptare, Banka Kombëtare e Greqisë – Dega në Shqipëri, Banka Kombëtare Tregtare, Banka e Kreditit të Shqipërisë, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Banka e Parë e Investimeve – Shqipëri, Banka Popullore, Banka ProCredit, Banka e Tiranës, Raiffeisen Bank – Shqipëri, Banka Union, Banka e Bashkuar e Shqipërisë .

2. Baza e Përgatitjes

Librat dhe regjistrimet kontabël të AAB mbahen sipas një modeli të modifikuar të kontabilitetit me bazë cash-i. Konkretisht, të ardhurat njihen si të tilla pasi arkëtohen dhe jo kur konstatohen dhe shpenzimet njihen kur paguen dhe jo kur kryhen, me përjashtim të veprimeve lidhur me pajisjet dhe tokat dhe ndërtesat, të cilat kapitalizohen dhe amortizohen gjatë gjithë periudhës së pritshme të përdorimit.

3. Përmbledhje e Politikave Kontabël

3.1 Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Të ardhurat regjistrohen kur arkëtohen dhe shpenzimet kur paguhen.

3.2 Aktivitetet e Qëndrueshme

Aktivitetet e qëndrueshme mbahen me kosto, minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi kryhet sipas metodës lineare, duke shpërndarë koston e pasurisë dhe të pajisjeve, përgjatë gjithë periudhës së pritshme të përdorimit të tyre. Amortizimi fillon të regjistrohet që nga muaji pasardhës i atij të blerjes, me normat e mëposhtme:

	Në %
Mobilje	20
Pajisjet Elektronike	25

3.3 Konvertimi nga monedha e huaj

AAB përdor si monedhë bazë LEK-un (ALL). Të gjithë kontributet dhe pjesa dërrmuese e shpenzimeve janë në Dollarë Amerikanë (USD). Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në LEK me një kurs që i përafrohet atij të datës së kryerjes së transaksionit. Aktivitetet dhe pasivitetet janë konvertuar në LEK, duke përdorur kursin e këmbimit të AAB, i cili është i përafërt me kursin e Bankës së Shqipërisë. Diferencat nga kursi i këmbimit janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.4 Tatimet dhe Taksat

AAB është një shoqatë jofitimprurëse dhe si e tillë është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në Shqipëri. AAB është subjekt i tatimit në burim, i tatimit mbi të ardhurat personale dhe i kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare 31 dhjetor 2006

(Të gjitha në LEK përveçse kur përcaktohet ndryshe)

4. Arka dhe Banka

Arka dhe banka përbëhen nga sa më poshtë:

	31 Dhjetor 2006	31 Dhjetor 2005
Arka	26,334	57,241
Banka	8,512,710	2,579,239
	8,539,044	2,636,480

Arka përbëhet nga sa më poshtë:

	31 Dhjetor 2006	31 Dhjetor 2005
Llogaria korente:		
Në LEK	5,159,975	1,347,174
Në USD	-	11,894.82
Në EUR	27,070.93	-

5. Aktivët e Qëndrueshme

Aktivët e qëndrueshme përbëhen nga sa më poshtë:

	Orendi	Pajisje Elektronike	TOTALI
Kosto			
Në 31 dhjetor 2005	588,567	618,485	1,207,052
Shtesat gjatë vitit	-	-	-
Pakësimet gjatë vitit	-	-	-
Në 31 dhjetor 2006	588,567	618,485	1,207,052
Amortizimi i Akumuluar			
Në 31 dhjetor 2005	102,528	101,650	204,178
Amortizimi gjatë vitit	97,208	84,882	226,417
Pakësimet gjatë vitit	-	-	-
Në 31 dhjetor 2006	199,736	230,859	430,595
Vlera Neto e Librit			
Në 31 dhjetor 2005	486,039	516,835	1,002,874
Në 31 dhjetor 2006	388,831	387,626	776,457

Shënime mbi Pasqyrat Financiare 31 dhjetor 2006

(Të gjitha në LEK përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Kuotat e Anëtarësimit

Të ardhurat e arkëtuara gjatë 2005 dhe 2004 janë si vijon:

	2006	2005
Kuotat e anëtarësimit në LEK	10,170,000	2,250,000
Kuotat e anëtarësimit në Monedhë të Huaj	-	6,121,578
Totali	10,170,000	8,371,578

7. Interesat Bankare

Interesat bankare përfshijnë:

	2006	2005
Interesat nga llogaritë korente në LEK	-	5,760
Interesat nga llogaritë korente në Monedhë të Huaj	-	6,215
	-	11,975

8. Të Ardhura të Tjera

Të ardhurat e tjera detajohen si vijon:

	31 Dhjetor 2006	31 Dhjetor 2005
Kuotat e pranimit	171,202	124,296
	171,202	124,296

9. Amortizimi i Akumuluar

	2006	2005
Amortizimi i akumuluar për pajisjet elektronike	129,209	72,938
Amortizimi i akumuluar për pajisjet e zyrës	97,208	69,791
	226,417	142,729

Shënime mbi Pasqyrat Financiare 31 dhjetor 2006

(Të gjitha në LEK përveçse kur përcaktohet ndryshe)

10. Shpenzimet e Përgjithshme dhe të Administrimit

Shpenzimet e përgjithshme dhe të administrimit në 2006 dhe 2005 përbëhen nga sa vijon:

	2006	2005
Pagat	3,481,547	2,758,965
Sigurime Shoqërore & Tatime mbi të Ardhurat Personale & të Tjera	1,114,526	533,866
Shpenzime Qeraje	195,950	299,259
Shpenzime Anëtarësie	375,582	461,331
Shpenzime për Udhëtime Pune	735,353	241,447
Shpenzime për Argëtim	1,105,016	676,342
Shpenzime për Reklama & Internet	550,890	67,096
Taksa Vendore	6,000	47,872
Mjete Zyre dhe Sërbime Utilitare	90,218	135,338
Shpenzime të Tjera	72,350	436,376
Shpenzime për Komisione Bankare	36,112	20,112
	7,763,544	5,678,004

11. Diferencat nga Kursi i Këmbimit

Diferencat nga kursi i këmbimit në 2005 dhe 2004, janë si vijon:

	2006	2005
Diferencat nga Kursi i Këmbimit	19,044	36,832
	19,044	36,832



ALPHA BANK



Andreas Galatoulas
Drejtore i Përgjithshëm



Alpha Bank – Shqipëri
Bulevardi “Zogu i Parë” No. 47, Tiranë,
Tel: +355 4 240 476/233 359
Fax: +355 4 232 102
<http://www.alpha.gr>

Themeluar në Shqipëri: Janar 1998


	ALL	EUR
Mjetet	36.918.042.100	298.086.735
Huatë	20.219.582.005	163.258.635
- Huatë për Biznes	12.793.996.658	103.302.355
- Huatë për Individë	7.425.585.347	59.956.281
Kapitali Aksioner	4.268.654.059	34.466.323
Depozitat	29.252.347.823	236.191.747
- Depozitat e Bizneseve	9.056.220.510	73.122.491
- Retail deposits	20.196.127.312	163.069.256
Fitimi Neto	902.341.772	7.285.763

Nr. i degëve dhe agjensive

15

Nr. i punonjësve

106





Banka Amerikane e Shqipërisë



Lorenzo Roncari
*President & Drejtor i
Përgjithshëm Ekzekutiv*



Banka Amerikane e Shqipërisë

Rruga "Ismail Qemali", No. 27, P.O. Box. 8319,

Tiranë, ALBANIA

Tel: +355 4 276 103

Fax: +355 4 237 570

<http://www.albambank.com>

Themeluar në Shqipëri: Maj 1998

	ALL	EUR
Mjetet	80.290.638.000	648.289.000
Huatë	25.199.127.000	203.465.000
- Huatë për Biznes		
- Huatë për Individë		
Kapitali Aksioner	4.061.839.000	32.796.000
Depozitat	55.442.100.000	447.655.000
- Depozitat e Bizneseve		
- Depozitat e Individëve		
Fitimi Neto	947.014.000	7.646.000

Nr. i degëve dhe agjensive	21
Nr. i punonjësve	367



BANKA CREDINS



Artan Santo
Drejtor i Përgjithshëm



Banka Credins

Rruga "Ismail Qemali", No. 21, Tiranë, SHQIPERI

Tel: +355 4 258 252, 234 096

Fax: +355 4 222 916

<http://www.bankacredins.com>



Themeluar në Shqipëri: Mars 2003

	ALL	EUR
Mjetet	27.540.422.000	222.369.172
Huatë	10.918.460.000	88.158.740
- Huatë për Biznes	9.540.532.000	77.032.959
- Huatë për Individë	1.377.928.000	11.125.781
Kapitali Aksioner	1.441.439.000	11.638.587
Depozitat	23.564.802.000	190.268.887
- Depozitat e Bizneseve	5.596.875.000	45.190.752
- Depozitat e Individëve	17.967.927.000	145.078.135
Fitimi Neto	228.696.000	1.846.556

Nr. i degëve dhe agjensive	17
Nr. i punonjësve	170



**BANKA
CREDINS**



CBA BANKA E KREDITIT TE SHQIPERISE



Kamal Abdel Monein Aly
Drejtor Ekzekutiv

CBA



Banka e Kreditit të Shqipërisë

Rruga "Perlat Rexhepi", Al Kharafi Group
Administration Building, Kati 1 & 2,
Tiranë, SHQIPERI

Tel: +355 4 272 168

Fax: +355 4 258 752

<http://www.creditbankofalbania.com.al>

Themeluar në Shaipëri: Gusht 2002

	ALL	EUR
Mjetet	1,601,316,000	12,929,479
Huatë	186,653,000	1,507,089
- Huatë për Biznes		
- Huatë për Individë		
Kapitali Aksioner	857,276,000	6,921,889
Depozitat	715,047,000	5,773,492
- Depozitat e Bizneseve		
- Depozitat e Individëve		
Fitimi Neto	(9,831,000)	(79,378)

Të dhëna të paudituar

Nr. i degëve dhe agjensive	3
Nr. i punonjësve	31





Emporiki Bank



George Caracostas
Drejtor i Përgjithshëm



Banka Emporiki – Shqipëri

“Rruga “Kavajës”, Tirana Tower, Tiranë, SHQIPERI

Tel: +355 4 258 755

Fax: +355 4 258 752

<http://www.emporiki.gr>

Themeluar në Shqipëri: Nëntor 1999

	ALL	EUR
Mjetet	12.626.331.000	101.948.575
Huatë	9.829.592.000	79.366.911
- Huatë për Biznes	5.445.594.000	43.969.269
- Huatë për Individë	4.383.998.000	35.397.643
Kapitali Aksioner	1.473.522.000	11.897.634
Depozitat	5.735.192.000	4.630.766
- Depozitat e Bizneseve	2.397.310.000	19.356.562
- Depozitat e Individëve	3.337.882.000	26.951.003
Fitimi Neto	171.893.000	1.387.913


Nr. i degëve dhe agjensive

7

Nr. i punonjësve

94






FIRST INVESTMENT BANK



Martin Bogdanov
Drejtor i Përgjithshëm



Banka e Parë e Investimeve

Blvd. "Dëshmorët e Kombit" KULLAT BINJAKE,

Kulla 11, kati 15, Tiranë, Shqipëri

Fax: +355 4 280 210

<http://www.fibank.com.al>

	ALL	EUR
Mjetet	2.205.852.072	17.810.675
Huatë	210.847.606	1.702.443
- Huatë për Biznes	158.323.864	1.278.352
- Huatë për Individë	52.523.742	424.091
Kapitali Aksioner	935.702.362	7.555.126
Depozitat	1.037.747.841	8.379.070
- Depozitat e Bizneseve	401.035.324	3.238.073
- Depozitat e Individëve	636.712.517	5.140.997
Fitimi Neto	(71.766.320)	(579.462)

Nr. i degëve dhe agjensive	3
Nr. i punonjësve	48

FIRST INVESTMENT BANK



BANKA NDERKOMBETARE TREGTARE



Mahendra Singh Rawat
Drejtore i Përgjithshëm



Banka Ndërkombëtare Tregtare

Rruga "Murat Toptani", "Eurocol Center",
Tiranë, SHQIPERI

Tel: +355 4 254 372/256 254

Fax: +355 4 254 386

<http://www.icbankingroup.com>

	ALL	EUR
Mjetet	3.713.075.000	29.980.420
Huatë	1.149.368.000	9.280.323
- Huatë për Biznes		
- Huatë për Individë	1.149.368.000	9.280.323
Kapitali Aksioner	922.420.000	7.447.880
Depozitat	2.766.440.000	22.337.021
- Depozitat e Bizneseve	84.257.000	680.315
- Depozitat e Individëve	2.682.183.000	21.656.705
Fitimi Neto	15.733.000	127.032

Nr. i degëve dhe agjensive	5
Nr. i punonjësve	54





BANKA ITALO SHQIPTARE
BANCA ITALO ALBANESE



Luigi Mastrapasqua
Drejtor i Përgjithshëm



Banka Italo-Shqiptare

Rruga "Barrikadave", No. 70, Tiranë

Tel: +355 4 233 965

Fax: +355 4 235 700

<http://www.bia.com.al>

Themeluar në Shaipëri: Maj 1993

	ALL	EUR
Mjetet	22.358.841.030	180.531.619
Huatë	6.485.493.058	52.365.709
- Huatë për Biznes	4.972.359.270	40.148.238
- Huatë për Individë	1.513.133.789	12.217.471
Kapitali Aksioner	1.650.217.375	13.324.323
Depozitat	19.741.251.017	159.396.456
- Depozitat e Bizneseve	8.557.937.074	69.099.209
- Depozitat e Individëve	11.183.322.543	90.297.315
Fitimi Neto	(423.092.410)	(3.416.168)

Nr. i degëve dhe agjensive	6
----------------------------	---

Nr. i punonjësve	88
------------------	----





Banka Italiane e Zhvillimit



Libero Catalano
Drejtor i Përgjithshëm



Banka Italiane e Zhvillimit

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", KULLAT BINJAKE, Kulla I,
Tiranë, ALBANIA

Tel: +355 4 280 355

Fax: +355 4 280 356

<http://www.bisbanca.com>

	ALL	EUR
Mjetet	2.156,298,079	17,410,562
Huatë	1.087,899,686	8.784.010
- Huatë për Biznes	702.628.075	5.673.218
- Huatë për Individë	385.271.611	3.110.792
Kapitali Aksioner	799,223,206	6,453,155
Depozitat	1.024,861,750	8,275,024
- Depozitat e Bizneseve	750,889,449	6,062,894
- Depozitat e Individëve	273,972,301	2,212,130
Fitimi Neto	-164.467.232	-1.327.955

Nr. i degëve dhe agjensive	2
Nr. i punonjësve	27





NBG Bank



Spiro Brumbulli
Drejtor



Banka Kombëtare e Greqisë – Dega Shqipëri

Rruga “Durrësit”, Tiranë, SHQIPERI

Tel: +355 4 233 621

Fax: +355 4 233 613


<http://www.nbg.gr>

Themeluar në Shqipëri: Nëntor 1996

	ALL	EUR
Mjetet	17.650.245.008	142.513.080
Huatë	12.840.150.756	103.675.016
- Huatë për Biznes	4.570.901.018	36.906.750
- Huatë për Individë	8.269.249.738	66.768.266
Kapitali Aksioner	1.724.917.222	13.927.471
Depozitat	10.053.302.564	81.173.214
- Depozitat e Bizneseve	1.252.802.572	10.115.483
- Depozitat e Individëve	8.800.499.992	71.057.731
Fitimi Neto	215.581.600	1.740.667

Nr. i degëve dhe agjensive 13

Nr. i punonjësve 154





BANKA KOMBETARE TREGTARE



Seyhan Pencapligil
Drejtor i Përgjithshëm



Banka Kombëtare Tregtare

Bulevardi "Zhan D'Ark" Tiranë

Tel: +355 4 250 955

Fax: +355 4 250 956

<http://www.bkt.com.al>

Themeluar në Shqipëri: Janar 1993

	ALL	EUR
Mjetet	80.884.843.640	653.087.151
Huatë	21.703.897.157	175.243.417
- Huatë për Biznes	15.303.070.335	123.561.327
- Huatë për Individë	6.400.826.822	51.682.090
Kapitali Aksioner	4.201.971.358	33.927.908
Depozitat	75.170.727.884	606.949.760
- Depozitat e Bizneseve	17.327.602.884	139.907.976
- Depozitat e Individëve	57.843.125.000	467.041.784
Fitimi Neto	1.067.762.876	8.621.420

Nr. i degëve dhe agjensive	33
Nr. i punonjësve	439



Banka Popullore



Edvin Libohova
Drejtor i Përgjithshëm

Banka Popullore

Blvd. "Dëshmorët e Kombit" KULLAT BINJAKE, Kulla I

Tiranë, SHQIPERË

Tel: +355 4 280 442/3

Fax: +355 4 280 441

<http://www.bpopullore.com>



Themeluar në Shqipëri: Mars 2004

	ALL	EUR
Mjetet	28.659.865.000	231.407.872
Huatë	9.205.548.000	74.328.203
- Huatë për Biznes	5.139.977.000	41.501.631
- Huatë për Individë	4.065.571.000	32.826.572
Kapitali Aksioner	1.547.989.000	12.498.902
Depozitat	26.142.085.000	211.078.603
- Depozitat e Bizneseve	3.250.542.000	26.245.797
- Depozitat e Individëve	22.891.543.000	184.832.806
Fitimi Neto	61.266.000	494.679

Nr. i degëve dhe agjensive	30
Nr. i punonjësve	284





ProCredit Bank



Frieder Wöhrmann
Drejtor Ekzekutiv



Banka ProCredit

Rruga "Sami Frashëri", P.O. Box 2395, Tiranë, SHQIPERI

Tel: +355 4 271 272

Fax: +355 4 271 276

<http://www.procreditbank.com.al>

Themeluar në Shqipëri: Shkurt 1999

	ALL	EUR
Mjetet	27,391,925,000	221.170.166
Huatë	11,343,490,774	91.590.559
- Huatë për Biznes	9,875,305,382	79.736.014
- Huatë për Individë	1,468,185,392	11.854.545
Kapitali Aksioner	2,144,069,000	17.311.821
Depozitat	23,772,649,051	191.947.106
- Depozitat e Bizneseve	1,875,792,627	15.145.681
- Depozitat e Individëve	21,896,856,424	176.801.425
Fitimi Neto	376,404,000	3.039.193

Nr. i degëve dhe agjensive	21
Nr. i punonjësve	568





Raiffeisen **BANK**



Steven Grunerud
Drejtor i Përgjithshëm



Raiffeisen Bank – Shqipëri
European Trade Center, Blvd. “Bajram Curri”
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 222 669
Fax: +355 4 230 013
<http://www.raiffeisen.al>

Themeluar në Shqipëri: Qershor 1991

	ALL	EUR
Mjetet	221.045.241.698	1.784.781.927
Huatë	37.390.443.762	301.901.040
- Huatë për Biznes	20.406.497.162	164.767.842
- Huatë për Individë	16.983.946.600	137.133.198
Kapitali Aksioner	10.464.627.139	84.494.365
Depozitat	203.867.587.759	1.646.084.681
- Depozitat e Bizneseve	20.390.299.641	164.637.058
- Depozitat e Individëve	183.477.288.118	1.481.447.623
Fitimi Neto	3.565.072.768	28.785.408

Nr. i degëve dhe agjensive	93
Nr. i punonjësve	1.263





Dimitris Frangetis
Drejtore i Përgjithshëm



Banka e Tiranës

Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit" Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 269 430


Fax: +355 4 247 140

<http://www.tiranabank.net>

Themeluar në Shqipëri: Gusht 1996

	ALL	EUR
Mjetet	49.945.531.000	403.274.372
Huatë	25.943.241.000	209.473.080
- Huatë për Biznes	18.177.444.000	146.769.834
- Huatë për Individë	7.765.797.000	62.703.246
Kapitali Aksioner	3.425.750.000	27.660.476
Depozitat	42.864.472.000	346.099.895
- Depozitat e Bizneseve	9.713.643.000	78.430.706
- Depozitat e Individëve	33.150.829.000	267.669.189
Fitimi Neto	621.083.000	5.014.800

Nr. i degëve dhe agjensive	36
Nr. i punonjësve	377





UBA

Banka e Bashkuar e Shqipërisë



UBA

Abdel Waheed Alavi
Drejtor i Përgjithshëm



Banka e Bashkuar e Shqipërisë

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",

No. 8, Tiranë,

Tel: +355 4 228 387

Fax: +355 4 228 460

Themeluar në Shqipëri: Maj 1993

	ALL	EUR
Mjetet	4.671.805.740	37.721.484
Huatë	1.872.023.066	15.115.245
- Huatë për Biznes	1.396.138.902	11.272.821
- Huatë për Individë	475.884.164	3.842.424
Kapitali Aksioner	1.232.348.255	9.950.329
Depozitat	3.308.562.702	26.714.273
- Depozitat e Bizneseve	960.239.716	7.753.248
- Depozitat e Individëve	2.348.322.986	18.961.025
Fitimi Neto	22.919.949	185.062

Nr. i degëve dhe agjensive

4

Nr. i punonjësve

56





UNIONBANK



Gazmend Kadriu
Drejtor i Përgjithshëm



Union Bank

Bulevardi "Zogu I", pranë Stacionit të Trenit
Tiranë, SHQIPERI
Tel: 04-250-653
Fax: 04-250-654
<http://www.unionbank.com.al>

Themeluar në Shqipëri: Dhjetor 2005

	ALL	EUR
Mjetet	3.234.467.417	26.116.007
Huatë	468.888.234	3.785.937
- Huatë për Biznes	202.142.014	1.632.152
- Huatë për Individë	266.746.220	2.153.785
Kapitali Aksioner	920.497.473	7.432.358
Depozitat	1.503.668.349	12.141.044
- Depozitat e Bizneseve	658.617.819	5.317.867
- Depozitat e Individëve	845.050.530	6.823.177
Fitimi Neto	(183.095.842)	(1.478.368)

Nr. i degëve dhe agjensive

7

Nr. i punonjësve

90



RAPORTI
VJETOR
2006



RAPORTI
VJETOR
2006



Design by: **GREEN PRODUCTION**



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

RAPORTI VJETOR 2006



www.aab.al